

INTERVISTË ME VJOLLCA MEHËN

Mitrovicë | Data: 21 mars, 2022

Kohëzgjatja: 87 minuta

Të pranishëm:

1. Vjollca Meha (e Intervistuar)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Vjollcë, nëse mundeni me u prezantu? Me na tregu datën e lindjes? Vendin? Diçka për familjen e juaj t'parë?

Vjollca Meha: Unë jam Vjollca Meha, lindur më 11.11.1963. Familja ime, baba dhe nana, baba Rizah Meha dhe nana Azize Kajtazi Meha. Viteve '62-tës në Mitrovicë, fillimisht baba ka ardhë prej Prekazit, Prekazit të Ultë, për shkak të kushteve që fëmijtë e vet m'i shkollu edhe me pasë ni arsim sa më të mirë. Jemi gjashtë fëmi: tre vajza edhe tre djem. Baba ka qenë ndër mësuesit e parë të Kosovës. Ka punue, tanë kohën ka qenë n'arsim. Na ka shkollue me mundësitë e veta sa ka pasë.

Kemi jetu në Mitrovicë. Qyteti i Mitrovicës ka qenë shumë, shumë ma ndryshe tash prej kësaj situatës tash qysh osht'. Fëminia jonë ka qenë shumë e lumtur. Si fëmi kemi pasë shoqni, kemi dalë, kemi lujtë lojta të fëmive. Shkollën fillore e kom kry në "Abdullah Shaban" shumë afër shkollës, shpisë. Edhe zilja shkollës kur ka ra, n'atë kohë e kem dëgju n'shpi edhe kem vrapu për me shku n'shollë.

Shkollën e mesme e kam fillue në gjimnaz, ka qenë mësim i orientum. Viti i parë edhe i dytë, vitin e tretë kam kalu në gjimnaz matematikor, shkenca natyrore. E kam përfundu shkollën, gjimnazin. Për m'u regjistru atëherë... gjysa e klasës ka qenë të orientum për me shku me studiue në Prishtinë. Edhe dëshira ime ka qenë me shku në Prishtinë, por për shkak t'mundësive... se kemi qenë une e katërta studente n'familje edhe nuk kam pasë mundësi. Me kshillën e babës, "Kemi fakultetet ktu", se ka qenë Fakulteti Xehtarometalurgjik, që kanë qenë katër drejtime. Edhe ka qenë Shkolla e Naltë Teknike që i ka pasë dy drejtimet, e ka pasë shkollën e naltë elektros edhe maqinerisë.

Kështu që, kur kam shku me u regjistru jom... unë jom shku me regjistru teknologji se bursiste, kam qenë bursiste e industrisë kimike e shkollës fillore. Po mendoj, të mesmën, e për me vazhdu bursën është dashtë me pasë teknologjinë të regjistrume. E kur jom shku me regjistru teknologjinë, ka qenë ni referente aty, Preveza Prekazi edhe Kujtesa Prekazi. Edhe tha, "A ki qef me ardhë ma shpejtë me hi n'punë?" Atëherë synimi jonë ish sa ma shpejtë me kry edhe me hi n'punë, m'u punësu që m'i ndihmu edhe vetit edhe familjes.

Atëherë, thashë, "Po". Tha, "Pse s'po regjistrohesh në gjeologji?" Se gjeologjia ka qenë drejtim i ri i hapun atëherë viteve '80-ta, se unë jom gjenerata e tretë e gjeologëve. Edhe jam regjistru në gjeologji.

Edhe pse i kom pasë unë në shkollë të mesme disa shoqe që jonë kanë n'drejtimin e gjeologjisë në shkollë të mesme... m'ka interesu shkenca e tokës, po nuk kom qenë qaq e orientume për me shku në gjeologji, po me ndihmën e referentës jom orientu për me mbërri ma tepër, ma shpejt te punësimi.

Kështu që, përgjatë studimeve pesë vjeçare, kemi kalu shumë mirë, kemi pasë kolegë edhe të rajoneve tjera. Jemi marrë me aktivitete që janë zhvillu në kuadër të Departamentit të Gjeologjisë. Kam përfundu në '88-ën studimet edhe si i kom përfundu studimet kom qenë gjeologia e parë që kom, shqiptare që kom diplomu. Kom, jom shkue... prej vitit të tretë të shkollës të studimeve kom qenë studente, bursiste e "Trepçës", Stantërg, miniera me flotacion.

Kam shku me bisedu me drejtorin e minierës Burhan Kavajën edhe ai më ka orientu. Më ka thanë, "Deri më sa ta hapim ni konkurs, orientohu në ni shkollë me punu si profesoreshë. Mandej e hapim konkursin edhe t'marrim". Se si bursiste e kisha t'drejtën e punësimit ma lehtë se ish marrëveshja që studentat që ishin me bursë kishin përparësi për punësim. U hap konkursi n'fund të '88-ës, kurse ni gjysmë-vjetor të '88-ës kom punu në shkollë teknike.

Gjatë marshit të minatorëve që ka qenë, unë kom qenë në mësimdhanëse në Shkollën e Mesme Teknike, në paralele të ndame në xehtari-gjeologji, në Stantërg. Nxansat na kanë dalë, iu kanë bashkangjitë marshit edhe na i kemi përkrahë. Tani kom kalue në minierë. Jom pranue une edhe ni kolege e jemja, Mevlude Emini. Te dyjat përnehere jemi hi n'punë n'minierë, por osht' anulë konkursi.

Masi na kanë pranue osht' anulë konkursi për shkak që osht' anku sindikata se nuk bon veç shqiptaret m'i marrë e mos m'i marrë të tjera etnive. Kështu që, osht' përsëritë konkursi edhe janë pranue edhe dy serbë janë pranue me neve. Domethonë, jena pranue na dyjat edhe dy serbë i kanë pranue, jemi bo katër. Edhe ma herët kanë qenë edhe katër gjeologë tjerë në Departamentin e Shërbimit Teknik, se atëherë kemi qenë njësitë e ndame. Na e kemi pasë punën n'minierë, por kemi pasë edhe angazhimet në zyre. Kështu që, jemi konë t'lidhun me prodhim.

Anita Susuri: Zonja Vjollcë, kisha dashtë pak m'u kthy ma herët e pastaj e vazhdojmë kështu kronologjikisht në disa t'dhana që, po mendoj, me rrëfimin e juj. Thatë që baba juj ka qenë mësues, qysh osht' arsimu ai? Ku ka mësu ai?

Vjollca Meha: Ai osht' shkollue n'kushte shumë të vështira, se babgjyshi ka pasë familjen shumë të madhe, shumë të gjanë, dhe i pari fëmi që i ka shku n'shkollë ka qenë baba im. Ka shku edhe mixha, axha, që janë kanë moshatar gati, ni vit diferencë, po nuk ka mujtë, ai nuk ka dashtë me vazhdu shkollën edhe ky ka vazhdue. Ni kohë u shkue edhe msheft babës që mos me ditë që po shkon në shkollë.

Derisa u shku ngatë shkollës ka pasë qelëshën plisin edhe kur u shku n'shkollë e ka hjekë edhe u hi në shkollë ka majtë msimin edhe u kthy. Kur u kthy prapë... tani ka kuptu baba, babgjyshi që po shkon nëshkollë edhe i ka thanë, "Ani, vazhdo!" Edhe ai ka vazhdue, ka pasë ni pesë... u kanë pesë-vjeçarë shkollimi, tani ka qenë tetë-vjeçarë. tani masi e kanë kry tetë-vjeçaren, tani prapë osht' ndrru sistemi kanë vazhdue dy vjet, i ka krye në Prizren. Tani mas Prizrenit, prapë ka qenë Akademi [Shkolla e Lartë] Pedagogjike në Prishtinë edhe ma vonë i ka kry edhe dy vite akademi pedagogjike edhe ka qenë mësimdhenës i ciklit të ultë.

Anita Susuri: Ju si fmi, a ju kujtohet Mitrovica? Sigurisht që ju kujtohet çfarë vendi ka qenë, po nëse mundeni me na përshkru atë mahallën ku keni jetu qysh ka qenë? Çfarë popullsi ka pasë?

Vjollca Meha: N'rrugën na që kemi qenë, kemi qenë ma afër qendrës. Popullsia ka qenë jo gjithë të arsimum. N'rrugën time kanë qenë baba im ka qenë mësues. Ni dajë imi ka qenë t'u punu, por ka punu punëtor i industrisë kimike edhe ni fqinj aty ka qenë edhe ai punëtor. Por punëtor me, moler u kanë, në industri kimike edhe të tjerë ma tepër kanë qenë që kanë qenë të lidhur me "Trepçën". Dy kojshi tjerë kanë qenë metalurgji të plumbit në Zvečan t'u punu. E gjeneratat tona janë konë, si fëmi, jemi konë secili i ka pasë kah ni, nga ni të gjeneratës që jemi kanë në shkollë bashkë.

Anita Susuri: A ka pasë edhe serbë?

Vjollca Meha: Edhe ka pasë...

Anita Susuri: Po mendoj, turqeli e?

Vjollca Meha: Në rrugën, në rrugën tonë jo. Në rrugën tonë jonë konë krejt shqiptarë, mirëpo në rrugën tjetër përballë shkollës "Abdullah Shaban" kanë qenë serbë nga katër-pesë shpi.

Anita Susuri: E qysh u jetu atëherë? A ka pasë fqinjësi t'mirë apo qysh ka qenë?

Vjollca Meha: Po, fqinjësia ka qenë e mirë, kanë qenë të qetë, derisa kanë fillue lëvizjet. Se në '68-ën veç kanë fillu pak zhvillimet, e në '74-tën ma me aprovimin e Kushtetutës së Kosovës që ka pasë e kemi pasë pak ma shirë, ma... kena pasë gjuhën me folë ma shirë, me dëgju muzikë, kemi dëgju... na n'shpi kemi pasë televizorin, domethonë prej familjes t'parë gati kemi pasë televizion. Ka qenë ajo "Iskra" e Nishit, bardh e zi. Edhe tash tonë natën, po mendoj, çdo herë e pritshim ka qenë ni emision shqip, "Bujku", të dillën. Ato janë përfshi krejt aktivitetet shqip të Kosovës edhe çdo herë e kemi pritë atë pjesë me kqyrë ose n'mramje jemi grumbullu me kqyrë ni film vizatimor, janë konë pesë minuta para se me fillu "Ditari", lajmet.

Kështu që, ka qenë ni kënaqësi, se kur ka pasë diçka për Vit të Ri ose për Vit të Ri jemi tubu. Ka pasë muzikë shqip e pritshim me shumë gëzim ni kangë që u knojke shqip, se atëherë janë konë edhe festivalet janë konë edhe serbisht edhe shqip, dy gjuhësia, turqisht e... Veç na qefin ma t'madh, entuziazmin ma t'madh kur dilke ni këngëtar shqip me këndu. Ka knue ky, Qamili i Vogël. Ne kemi pasë edhe ni kasetofon kështu me traka. Burri hallës ka punue në Gjermani, djali i çikës të hallës ka punu në Gjermani edhe baba e ka porositë. Se baba ka pasë qef muzikë, a din, ka pasë mandolinë, i ka ra mandolinës. Edhe tani çdo herë na ka frymëzu neve që muzika osht' shërim i shpirtit, osht' mirë me dëgju muzikë mos me, me kanë pak ma i lumturushëm, ma i gëzushëm.

Na gjithë... po kemi dëgju muzikë ma shumë populllore, po dikur ma vonë viteve të '80-a edhe argëtuese. E festivalet i kemi pritë gjithë, Zambaku i Prizrenit u konë. A na që kemi pasë televizorin të parët prej familjes edhe festave, gjithë jemi grumbullue me të familjes.

Anita Susuri: A kanë ardhë edhe fqinjët, për shembull?

Vjollca Meha: Po, shoqet e kojshiket aty që i kemi pasë që jena kanë gjeneratë në shkollë, po bashkë.

Korab Krasniqi: Çfarë kangë janë konë që i keni dëgju atëherë që hala kur i dëgjon sot t'pëlqen?

Vjollca Meha: Fatime Sokoli kur e knon ni kangë, ata e kemi dëgju msheft përpara. Se baba jeme, radionin, e qitshim, dy-tri kat e kemi pasë shpinë edhe e qitke çdo dhomë e kontrollojke ku p'i rrokë valtë për me dëgju [Radio] Tiranën. Edhe qajo kangë. Zakonisht kangtë e vjetra kur tash që knohen jonë, e kanë ni kuptim ma ndryshe te une se e kom atë nostalgjinë me ndëgjue prap ato kangë.

Anita Susuri: Edhe ju kujtojnë babën ndoshta.

Vjollca Meha: Po. babën e nanën e familjen krejt afër. E tash osht' pak ma ndryshe, osht' ni zbrazëti, osht' ni... baba m'ka deké, nana m'ka deké, a din, edhe të kujtohet. Vjen meniherë ajo pamja qysh je kanë, ku e ke pasë babën ulun, se baba jem u ulke, e ka pasë kështu si venin e veçantë edhe na fëmija tjerë përreth.

Anita Susuri: E qysh ka qenë infrastruktura e lagjës? A kanë qenë shpijat e vjetra? Rrugtë? Qysh kanë qenë?

Vjollca Meha: Kur kemi ardhë na, ato shpijat, kulmet kanë qenë me ato tjegullat, qerpiq iu kanë thanë. Edhe baba jeme e ka rrënu atë shpi të vjetër që u kanë edhe ka ndërtu tani, e kemi ndërtu n'ato kushte mirë u kanë n'krahësim me.... Tani prapë në '88-ën e kemi hjekë, e kemi rrxu atë shpi edhe kemi maru njo tjetër. A lagjja ka qenë, nuk ka qenë e shtrume. Kanalizim s'kemi pasë, kemi pasë gropë septike, nuk... për ujë e kemi pasë pompën. E kemi pasë ni gyp, se këtu në Mitrovicë ka shumë ujë edhe veç e kemi pasë ni gyp të vendosun edhe e kemi pasë pompën edhe me pompë t'u i mshu. Kështu, ajo e ka nxjerrë ujin prej pusisë.

Anita Susuri: Prej oborrit apo?

Vjollca Meha: Në oborr. E ma vonë viteve të '80-të osht' hy kanalizimi n'rrugë, infrastruktura osht' ardhë edhe e kemi ngjijtë edhe ujësjellsin edhe kanalizimin.

Anita Susuri: Desha me ju pytë pak edhe për qytetin qysh ka qenë? Fëmijërinë e juq qysh e kujtoni?

Vjollca Meha: Une e maj mend si fëmi, [Hotel] Adriatiku, ka qenë Adriatiku në atinë Lushtës. Lushta ka qenë midis qytetit...

Anita Susuri: Lushta si?

Vjollca Meha: Lushta si lumë. Tash që osht', tash kalon, Lushta osht' e mbulume po osht' ni pjesë e dalne aty te Xhamia, te Xhamia e Madhe tash p'i thojnë. Aty osht' e nxjerrne pak kanali i Lushtës. Une e maj mend Lushta qysh u kanë krejt deri te Mokra Gora edhe nuk u kanë kjo e mbulume. Rruga kryesore, Mbretëresha Teutë s'u kanë, ka qenë, rruga ka qenë me kocka.

Anita Susuri: Me kalldrëm.

Vjollca Meha: Me kalldrëm. Edhe ma vonë tani u mbulu Lushta për arsye se sa herë ka pasë shira të mdhaja e ka marrë qytetin dhe shitoret që kanë qenë përballë [Hotel] Adriatikut, çdo herë i ka marrë uji. Edhe jonë kanë ni shitore e teshave Napredaku, po m'doket e Gjakovës, si i merrke uji tani ato i lirojshin. Bishin si n'aksion teshat edhe e kishe si mundësinë kaniherë edhe m'i marrë, se ato veç që lagështia pak edhe i kanë pastru.

Anita Susuri: E Adriatiku ka qenë restaurant a çka?

Vjollca Meha: Adriatiku hotel.

Anita Susuri: Hotel Adriatiku.

Vjollca Meha: E ka pasë atë, përpara e ka pasë... Lushta u konë edhe ngatë Lushtës u konë... ka kalu Lushta asajde. Edhe osht'... ka qenë ura që kanë kalu prej kësaj ane n'atë tjetrën anë. Kanë qenë tri ura edhe ni urë ka qenë qitu te kalldrëmi që lidhet qyteti i vjetër që shkon për shkollën e gjimnazin tash ku osht', osht' pazari vjetër a s'di qysh i kanë thanë.

Anita Susuri: Po.

Vjollca Meha: Atu edhe ni tjetër ka qenë ma poshtë, ngat hotelit aty, në Hotel Adriatiku.

Anita Susuri: Qysh ka qenë jeta në Mitrovicë atëherë dhe ka pasë gjallni u konë qytet industrial. Qysh ka qenë, për shembull, njerëzit, a ka pasë jetë kulturore? Me çka janë marrë njerëzit në kohë të lirë? Ju? Familja juj?

Vjollca Meha: Na qysh t'them, shkollë fillore jemi marrë me aktivitete sportive. Ka qenë kori i shkollës, ka qenë grupi i valltarëve të shkollës, kanë qenë ekipet e basketbollit edhe... por ma tepër kanë lujtë hendboll. Unë kom qenë me klasë kur lujshim edhe me shkolla kom qenë me hendboll. Po tani në shkollë të mesme t'u shtu aktivitetet, puna për me msue i kom ikë unë aktiviteteteve pak edhe s'jom mirrë.

Vllau u mirrë me sport, ka lujtë në "Trepçe", ka lujtë edhe në Zvezdën e Gilanit atëherë para luftës. Mirëpo, viteve të '90-a i mbyllën edhe ekipet e futbollit edhe as transferin s'ia kanë dhanë "Trepça" se ka qenë drejtori shka, nifarë Stoliqi, a s'e di qysh e ka pasë emrin. Nuk ia ka jep transferin për me shkum se vllau, dy vllaznit e mdhaj kanë shku, viteve '86 kanë dalë në Holandë. Tani ai vllau i madh masi lujke ky futboll e murrë me angazhu në ekipe atje, po nuk, s'mujti me marrë ky transferin edhe s'mujti me shku. Mandej ka kalue në Zvicërr vllau i vogël.

Anita Susuri: A keni shku, për shembull, me shoqni ose me familje me përcjellë ndonjë lojë?

Vjollca Meha: Po. Vllau që ka lujtë futboll, çdo here... unë jom shku nja dy here, ma s'jom shku se kom pasë përvojë të keqe. Jo që kom pasë une, por vllau sa herë u ardhë ka ardhë me lëndime. Jo e ka thy dorën, jo kamën, jo kamën e ka vra, jo n'stërvitje edhe s'jom... gjithë e kom pasë... edhe sot nuk e kom qaq kërkujna m'i thanë shko luj futboll, se m'doket ni sport shumë luftarak, i rrezikshëm (qeshë).

Anita Susuri: E sa i përket jetës...

Vjollca Meha: A kështu kemi shku n'koncerte, kemi pasë ditën e shkollës jemi shku n'ditë t'shollës se janë organizu aktivitetet, jo jonë konë matematicientët, gara e matematicientëve, jo historianëve, në shkollë fillore. Tani edhe në shkollë të mesme ia nisën me aktivitete. Por, na kur e kemi kry shkollën e mesme, domethonë s'kemi pasë maturë hiç, se u bonën trazirat e '81-tës edhe s'na kanë lanë me u tubue.

Anita Susuri: E kur i përmendët tash këto trazirat, a ju kujtohet juve? Keni qenë në Mitrovicë sigurisht, '81-ten, marsi, prilli. Qysh ka qenë qajo?

Vjollca Meha: '81-ten unë e kom vitin e dytë...

Anita Susuri: Të shkollës të mesme.

Vjollca Meha: Të shkollës të mesme. Jo në të vërtetë '81-tën jom konë, marsin, na jemi konë n'vitin e tretë në shkollën e mesme, gjimnazin jena konë në Zveçan. Se ni vit kemi qenë në Zveçan, ni vit kemi qenë në tenik këtu në Mitrovicë. Edhe në Zveçan kur jonë bo demonstratat janë ardhë edhe jemi dalë në rrugë. Kur jemi dalë në rrugë, Zveçani u konë qytezë, pjesa dërmuse kanë qenë serbë edhe për m'i ikë na asaj masës kemi dashtë me iu bashkangjitë punëtorëve të "Trepçës" edhe me ardhë knej qytetit. Nuk na kanë lanë edhe jemi shkue për Zveçan. Zveçani i vogël ku osht'. E kemi ecë nëpër... osht' pjesë malore, fushore, edhe kemi dalë në Suhodoll. Edhe prej Suhodollit, tani kemi ardhë kemi ra knena te tre rrokaqiejt që osht', se atëherë pjesa veriore ka qenë e banume me shqiptarë. Për ato dhe jemi shku jemi ardhë n'shpi jemi kthy, se nuk na kanë lanë me u bashkangjitë me puntorë.

Anita Susuri: E qysh u konë situata n'qytet për shembull? A ka pasë dhunë prej policisë apo ikje? Qysh ka qenë?

Vjollca Meha: Une kom qenë qit urën qitu e Sitnicës që osht' qitu kur u ardhë masa na kanë dalë policia përballë tunellit edhe i kanë gjujtë me armë. Unë i kom pa dy persona kanë kcy prej urës edhe kanë ra në Lushtë, në Sitnicë për me ikë. Edhe ni tjetër e kom pa që osht' plagosë. Kështu kur kanë gjujtë me armë e kom pa gjakun n'masë. E tash e gjithë ajo pamje metet kështu kur kaloj rrugës, urës kur kaloj më kujtohet ajo pamje.

Tani na, s'na kanë lonë me shku n'shollë derisa i kanë marrë masat. Tani kanë majtë kujdestari, kujdestari. S'kemi guxoftë me folë, se atëherë ia nisën "Republika e Kosovës", "Kosova punon, Beogradi ndërton". Emrin republikë s'kemi guxoftë me përmend, se me meniherë masa ndëshkimore u mirrshin, disiplinore, jo të përjashtojshin prej shkolle, jo kështu. E kemi majtë në heshtje me shokë klase edhe... jo me të gjithë se prej disave edhe u frigojshim. Për shembull, për do që e dishim që po i punojnë baballarët, po punojnë në SUP¹, na u rujsim pi tyne.

Anita Susuri: Atëherë u konë edhe do, literatura e ndalume, për shembull lidhun me Shqipninë, me, që e ndjellë atë nacionalitetin. A e keni lexu? A ju ka ra n'dorë si libra, për shembull që kanë qenë të ndalume?

¹ Sekretarijat Unutrašnjih Poslova - Sekretariati i Punëve të Brendshme. Ka qenë emërtimi i mëparshëm i milicisë, përkatësisht i policisë në kohën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Vjollca Meha: Baba jem ka punue me Fazli Grajçevcin në shkollë edhe kur e ka përgatitë ai ni dramë, kur e kanë marrë në burg Fazli Grajçevcin e ka përgatitë ai “Gjarprinjtë e Gjakut” e Adem Demaçit edhe na ka pru neve n’shpi, se ajo ka qenë literaturë e msheft. Na kemi lexu literaturë, se edhe motra e madhe e ka juridikun osht’, e ka kry edhe për avokat. Ajo ka lexu shumë romana, tani edhe unë i kom përcjellë romanet çka ka lexu ajo, e kështu jemi përcjellë. Zakonisht çka janë konë pak ma, i kemi pasë të msheft, kështu si në ilegale i kemi përcjellë. Kështu ku e kemi ditë që munet me lexu, se s’ia kemi shpërnda gjithkujt.

Anita Susuri: A keni qenë n’atë kohë të vetëdijshëm që kanë ekzistuar këto grupet, për shembull Ilegalja, organizata...

Vjollca Meha: Ma tepër informatat dilshin në televizion...

Anita Susuri: Kur u arrestojshin.

Vjollca Meha: Kur u arrestojshin edhe që në gazeta, se zakonisht edhe gazetat që i merrshim atëherë “Rilindja” u konë...

Anita Susuri: Qysh janë cilësu atëherë prej mediave, për shembull prej sistemit këta njerëz?

Vjollca Meha: Prej sistemit janë si terrorista, kundër shtetit, kundër... çdo herë si grupe kriminale i kanë cilësu. Edhe pse na edhe familjarisht nganjëherë i njifshim që s’janë, se janë tamon revolucionarë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Po du m’u kthi pak te profesioni që keni zgjedhë, gjeologe, thatë keni vazhdu n’këtë, me studimin e saj. Po a ka pasë shumë vajza që kanë shku n’këtë drejtim?

Vjollca Meha: Kur jom regjistru në vitin e parë jena konë dhetë a 15 jemi konë. Por, ngadalë dalë në vitin e dytë jonë ra. E kështu që, prej vitit tretë deri në vitin e pestë që kemi përfundu edhe studimet jemi konë veç une edhe qajo Mevlude Emini. Mandej gjeneratat e tjera, mas neve e katërta e pesta gjeneratë kanë pasë. Tash ka, është ni numër i konsiderueshëm i femrave që janë gjeologe. Po shumica fatkeqësisht për shkak të mbylljes të zinxhirit të industrisë janë metë edhe... veç i kanë kry edhe rrinë në shpi.

Anita Susuri: Thatë që keni qenë nandë-tetë vajza keni qenë...

Vjollca Meha: Po.

Anita Susuri: N’krahësim me djem, sa djem kanë qenë?

Vjollca Meha: Po në krahësim me djem, djem ka pasë ma shumë. Se edhe tash prej vitit tretë deri në vitin e pestë që kemi përfundu na dy femna jena kanë a janë kanë 20 mashkuj. E tash...

Anita Susuri: Po, qajo m'interesoi.

Vjollca Meha: Se, unë e kom pasë ni profesor edhe osht' ende gjallë, Valdet Pruthi. Ai thojke, "Femnat n'gjeologji osht' pak e shtirë, se osht' profesion që veç mashkujt duhet m'u mirrë". Po ai u konë doktor i shkencës, shkencave të gjeologjisë edhe kur ka magjistru ka magjistru në Zagreb, e aty tani në Zagreb ka pasë edhe femna tjera. Kështu që, nuk e ka pasë që me na injoru neve po dojke me na dhanë kaniherë kurajo, a din, se kaniherë edhe n'studime ishe e demoralizume se e pashim situatën qysh nuk po osht'.

Na kemi pasë edhe profesora të Beogradit që osht' duftë m'u përgjigjë edhe serbisht. Janë ardhë prej Beogradit e ka ligjëru landën për dy ditë e na u duftë me përgatitë landën edhe m'u përgjigjë serbisht, jo shqip. Shumica kanë kalu edhe për shembull, edhe në Beograd e kemi pasë atë t'drejtë me shku m'u pytë, po unë për veti s'jom shku...

Anita Susuri: A ka pasë që kanë shku?

Vjollca Meha: Kolegë tjerë kanë shku, po une s'jom shku se i kom pritë derisa janë ardhë ktu profesortë edhe jom shku m'u pytë.

Anita Susuri: Domethonë, ata kanë ardhë për dy ditë e kanë dhanë krejt landën kanë shku edhe veç n'provim?

Vjollca Meha: Po.

Anita Susuri: A ka qenë vështirë kjo?

Vjollca Meha: Ka qenë vështirë se na kemi pasë ligjerata prej mëngjesit deri n'mramje, prej 8:00 deri në 8:00 të mramjes edhe tani të nesërmen kanë vazhdu prapë prej 8:00 deri në 8:00 të mramjes edhe i ka pasë, për shembull, po edhe dy ditë tjera. Për shembull, se ka ndodhë që s'ka mujtë me përfundu krejt landën edhe kanë vazhdu edhe dy ditë tjera janë ardhë. Por, zakonisht janë ardhë, ni javë përpara kanë lajmëru që kemi m'i pasë ligjeratat veç te ai profesor, te ligjeratat tjera që kemi pasë i kemi lanë anash se s'kemi mujtë dy antë. Kështu që, kemi dëgju aty edhe tani ma së vështiri na ka ardhë se u dufke, ti e mson po osht' problem m'u shpreh. E çdo here qata e kemi pasë pak pengesë, po mirë kemi kalu.

Anita Susuri: Ka qenë n'gjuhën serbe...

Vjollca Meha: Serbe.

Anita Susuri: Edhe ka qenë ma vështirë sigurisht.

Vjollca Meha: Serbisht ke pasë m'u pytë edhe për shembull ai kur t'ka pytë me nënpytje t'ka pytë, prapë u dufke me u përgjegje.

Anita Susuri: E prej ktyne që thatë keni qenë vajza, a ka pasë edhe serbe?

Vjollca Meha: Ka pasë serbe, po një ka qenë para neve ajo ka ardhë, u kanë gjeneratë ma përpara. Tjerat jo, tjerat janë konë ma mrapa. Se na i kemi majtë ligjeratat e përbashkëta, për shembull shumicën e landëve i kemi pasë të përbashkëta.

Anita Susuri: Thatë që keni qenë edhe...

Vjollca Meha: Qita që kanë ardhë profesortë prej Beogradit, se kta që kanë studiu serbisht e kanë pasë landën serbisht.

Anita Susuri: Thatë që keni qenë bursiste e “Trepçës”, qysh ka funksionu kjo, domethonë në Mitrovicë e dijmë që shumica kanë pasë bursë prej “Trepçës”, keni qenë të obligum pastaj pas studimeve me shku me punu në “Trepçë”, a po? A osht’ qishtu?

Vjollca Meha: Po.

Anita Susuri: Qysh ka funksionu kjo për juve?

Vjollca Meha: Une kur kom konkuru vitin e parë, në studime kom konkuru për me pasë bursen po nuk ma kanë dhanë, as vitin e parë as vitin e dytë tek vitin e tretë. Se ma përpara i kanë dhanë përparësi fëmive të minatorëve, të punëtorëve të “Trepçës”, e baba im nuk u kanë punëtor i “Trepçës”. Bursa, ka qenë edhe Fondi i Titos atëherë, ai u konë bursi ma i fortë, po as ata s’na i kanë nda. Mu s’ma kanë nda, se une kom konkuru po s’ma kanë nda. Për arsye se baba im s’u konë anëtar i Lidhjes Komuniste, s’u konë n’parti. Edhe nëse nuk ish, se u dufke me çu si ni dëshmi që e ki babën në parti e kishe pak ma lehtësim. Po përmes, pasi e panë ata komisioni të arsyshme që une tri vite konkurova si studente e gjeologjisë, atëherë në vitin e tretë ma ndajtën bursën. Se përndryshe veç nëse e ki babën punëtor të “Trepçës” ki përparësi edhe pa hezitim i jepshin bursa. Qata e kom pasë une ni ndihmesë tek vitin e tretë.

Anita Susuri: Po du me pytë edhe për kto vitet e fakultetit qysh ka qenë jeta shoqërore në Mitrovicë? A ka pasë vende ku me dalë? A qysh ka qenë mentaliteti për vajzat me dalë? Se ka qenë ni vend pak ma i zhvillun, po mendoj, industrial qytet.

Vjollca Meha: Po fakulteti çdo vjet i ka organizu brucoshiadën edhe atë apsolvientiadën e janë konë edhe xehtariadat e teknologjiadat e ato janë zhvillu në nivel të krejt Jugosllavisë. Edhe shkojshin, për shembull caktojshin 20 vetë, dhetë vetë po edhe ato me aktivitete. Për shembull, kush lujke futboll, ekipet e futbollit u zgjidhshin ato ma tepër gara u majshin me sport edhe shkojshin. Femnat shqiptare pak ka pasë që kanë shku nëpër xehtariada e teknologjiada.

Anita Susuri: Ju a keni shku?

Vjollca Meha: Une, jo. Kështu në brucoshiada e apsolvientiada, kur jonë organizu apsolvientiada nuk ka qenë... kur kom apsolvu une nuk osht’ organizu. Brucoshiada nuk kom pasë qef vet me shku. A kështu në qytet kemi dalë, jonë konë lokalet, jonë konë lokalet për t’ri jemi dalë kemi pi kafe me shoqni, me... Kur kemi pasë pauza prej ligjeratës në ligjeratë jemi shku kemi pi, kemi nejt në lokale jemi kthy prapë. Kemi pasë kështu vizita mas, tani, kemi pasë vizita edhe në fakultete, jo nëpër miniera, jo nëpër, se në

Minierën e Bulljakës në Klinë, Klinë Begut jemi konë ni javë ditë praktikë se kemi pasë edhe terenin me profesorin Valdet Pruthin.

Kemi pasë programin e terenit edhe ni javë ditë kemi qenë në Motel Nora, ka qenë atëherë në udhëkryq aty të Klinë Begut për rrugë për Pejë edhe Gjakovë. Jemi konë bashkë edhe serbët edhe shqiptarët, krejt grupi se u konë landa qashtu që bashkë e kemi majtë. Ata serbët jonë dorëzu, ditën e parë, të dytën jonë kthy. Na e kemi vazhdu si grup.

Anita Susuri: Pse ka qenë vështirë a qysh?

Vjollca Meha: Po, ka qenë vështirë se e kemi pasë terenin e te liqejtë e Mirushës. Na kam kemi ecë krejt atë pjesë, kemi ba hartografim e punë tona si gjeologë. Ata s'mujtën me përballu edhe u kthyn (qeshë).

Anita Susuri: E në "Trepçë" a keni shku në minierë?

Vjollca Meha: Po, si gjeologe osht' profesion që duhesh me hi në minierë. Mirëpo, kemi pasë edhe punën e minierës edhe punën e zyrës.

Anita Susuri: Qysh ka qenë hera e parë kur keni hy në minierë?

Vjollca Meha: Kur kom hi herën e parë në minierë disa thojnë kemi pasë fobi, po mu m'u ka dokë shumë interesant, se s'di as nuk kom pasë këshut frikë as... po mirë kom kalu.

Korab Krasniqi: Si gjeologe, çka jonë përgjegjësitë ose çka jonë konë përgjegjësitë e tua në "Trepçë", qoftë n'zyre qoftë në minierë?

Vjollca Meha: Po përgjegjësitë si gjeologe na i kemi pa se i kemi promarrjen, përcjelljen hartografinë e ni punishte kah shkon xehja, për shembull, i bojmë planet, provat që i marrim i bojnë përshkrimin e bërthamës tani ato përcjelljet sa shkon shpenzimi i xehes për shembull, sa e shfrytëzojnë. Se osht' ni punë si vazhdim i xehtarëve. Se na e bojmë hulumtimin e gjojmë xehen kah shkon trupi xehror, xehtartë e përcjellin edhe e nxjerrin.

Anita Susuri: Xehtartë e kanë punën fizike, ju me matje me hulumtim?

Vjollca Meha: Po. Ma tepër e kem punën me... edhe xehtartë i kanë punimet xehtare qysh duhet m'i bo kamatisjen qysh duhet m'i bo... a te na shkon edhe te projektimi se kah duhet me çelë koridorin, duhet me çelë prerjen e trupave.

Korab Krasniqi: E puna në zyre qysh ka qenë?

Vjollca Meha: Pastaj vazhdojmë punën n'zyre. Aty bohen matjet në teren, tani në zyre i qet në plan. Planet janë, planet gjeologjike mirren prej planet gjeodezike, se ata i bojnë matjet tani na i inkorporojmë planet gjeodezike në planet gjeologjike.

Anita Susuri: Kisha dashtë me ditë pak ma shumë për punën e ju, thatë që keni fillu në janar të vitit '89, qysh ka shku krejt puna edhe qysh ka qenë ndërmjet juve kolegëve marrëdhënia, bashkëpunimi?

Vjollca Meha: Kur kemi fillu na, bashkëpunimi ka qenë i mirë. Po në shërbimin teknik t'them 80 përiqnd kanë qenë serbë. Po në shërbimin teknik janë konë katër edhe gjeologët edhe gjeodetët edhe projektantët. Se projektantët kanë bo projektet, gjeodetët kanë bo matjet, kurse na gjeologët kemi bo hartat edhe planet gjeologjike. Tani mandej kanë fillu edhe te prodhimi, pjestë tjera. Po kanë qenë njësitë ndamas. Kështu që prej, se punëtortë e "Trepçës", miniera i ka pasë 2000 e kusur punëtorë dhe janë konë njësitë ndamas.

Ka qenë ni harmoni në fillim, por ajo veç u ftof ajo bashkëpunimi. Drejtusi që ka qenë drejtusi t'them shka se ai u konë edhe magjup edhe shka edhe, osht' mundu me zor me na bashkue neve. Se na i kemi pasë zyren gjeologët edhe tekniktë bashkë, i kemi pasë, ata serbtë tani kur hishim në shërbim, jena konë gjashtë gjeologë, ata jonë konë dy edhe nuk kanë nejtë me neve kurrë. Janë shku, e kanë pasë ni zyre ka qenë ni vizatuese serbe dhe kanë nejtë te ata. Na kanë hjekë ndërmjetësen, e kemi pasë telefonin n'mes se telefoni fiks ka qenë i zyrës, na kemi qenë knej tekniktë kanë qenë ndamas tjetrën anë.

E ka hjekë atë pjesë e kanë mbyllë derën për me hi për njanën derë edhe me qenë na ma të përafërt. Por na prapë, se ish ajo ftoftësia nuk kishim, veç zyrtarisht diçka jo ma tepër se tani ato lindën edhe mosmarrëveshjet me teknikët se akuzojshin, "Çka po lypni ju?" Se n'rrugë që u lypke demokraci edhe fëmia e vogël n'rrugë kur u dalë, "Demokraci, demokraci!" Tani ato na e gjujshin si, na sulmojshin faktikisht, "Çka po dojnë edhe fëmia demokraci? Ja u kisha bo kështu, ja u kisha bo kështu..." Ia nisën me u shpërfaqë tani krejt ato nacionalizmin që e kanë ata kundër neve. Kështu që, s'kemi pasë [raporte], veç zyrtarisht ashtu se jo.

Anita Susuri: Thatë edhe për punën e ju që osht' lidhë edhe me punë praktike mrena në minierë, po nëse mundeni me na përshkru qato pajisjet me t'cilat keni punu ose punën pak ma n'detaje ose çka keni zbulu diçka që ka qenë interesante gjatë punës?

Vjollca Meha: Ne kur kemi shku n'minierë nuk kemi shku vet, zakonisht jemi shku dy kolegë. Po e kemi pasë edhe teknikën, dy inxhinierë e kanë pasë ni teknike. Ai e ka pasë për detyrë me përgatitë planin edhe na veç e kemi marrë planin jemi shku edhe faktikisht anën teknike e ka kry teknikja. Kur jemi hi kemi pasë busollën, planin me veti, lapsin edhe kemi, edhe kemi hi në punishte kemi bo hartografim të punishtes. Ja kemi jep planin teknikës, teknika e ka pasë për detyrë mandej me vazhdu procedurat.

Mirëpo, kur jena shku na në minierë, ka qenë ni gjallni edhe në korpë të punëtorëve se kur u lshu ndrrimi. Na zakonisht si inxhiniera të gjeologjisë nuk jemi lshu me ndrrim në minierë, masi u lshu ndrrimi na jena lshu në minierë edhe jemi dalë para se me dalë ndrrimi se me bo me t'nxon ndrrimi je mbetë deri në fund. Dhe kur jena dalë na prej minierës asnihere nuk jena bo... se jonë banjot e punëtorëve edhe banjot e inxhinierave jonë konë atëherë. Na nuk kemi bo, se jonë konë ndamas banjot inxhinierat, veç i kemi la durte, dytë, i kemi hjekë teshat e punës edhe kemi vazhdu n'zyre.

Anita Susuri: A osht' aty mrena në minierë ni pjesë e veçantë ku ndrrohen teshat? Veshen teshat?

Vjollca Meha: Po osht' ni sipërfaqe.

Anita Susuri: A n'sipërfaqe.

Vjollca Meha: Jo, n'sipërfaqe osht', në sipërfaqe osht'.

Anita Susuri: E që e përmendët hartografia, qysh u bo kjo? Çka domethonë kjo? Ku jonë xehet?

Vjollca Meha: Jo, qitet n'letër, hyn e sheh natyrën edhe orientohesh. Për shembull, e ki planin mbas planit të hymjes në punishte e sheh edhe e përcjellë kah ki xehe i shkrun, për shembull, qikjo pjesë osht' xehe, qikjo pjesë osht' shkamb, qikjo pjesë osht', a din, bohet përshkrimi, ni lloj përshkrimesh. Për shembull, si në mënyrë vizuele. Mirëpo, e ki në bazë të planit, pa plan s'munësh me shku.

Anita Susuri: Çfarë minerale, po mendoj, ka t'dhana çfarë minerale ka "Trepça" e kto po në çka keni hasë ju ma shumë?

Vjollca Meha: Po zakonisht osht' xehja e sulfidit, plumbit edhe zinkut edhe perikun. Por periku ka përmbajtje të sulfurit ma shumë edhe hekurit nuk e kanë shfrytëzu. Mirëpo, zgavrat natyrore, kanë hasë edhe në zgavrat natyrore që janë hasë kristalet, në qato zgavra natyrore është nxjerrë kristalet, janë dalë lloj lloj kristalesh. Është specifikë e mineraleve se format që vijnë kristalet mundet me qenë përmbajtja e njejtë, po forma nuk mundet me kanë e njejtë. Çdo herë vjen ndryshe ndryshe, se osht' përbërja gjeologjike e minierës osht' e tillë që ka pasë lloje t'ndryshme të mineraleve.

Anita Susuri: A ka pasë edhe ari e argjend?

Vjollca Meha: Në horizontet e para të themi ka pasë edhe ari të lindun, po ai osht' shfrytëzu në vitet e '30, tash me shfrytëzimin e minierës osht' bo edhe thellimi i minierës. Tash ajo horizonti i dymbëdhjetë t'u punu osht' 15 metra, deri në 35 metra nën nivel të detit mendohet me shku.

Anita Susuri: E horizonti dymbëdhjetë që e përmendët.

Vjollca Meha: Dymbëdhjetë, ma poshtë.

Anita Susuri: Dymbëdhjetë është nën minerale apo qysh?

Vjollca Meha: Po krejt miniera osht' me minerale.

Anita Susuri: Po mendoj i zhytun kështu, nuk osht' i përpunun.

Vjollca Meha: Po veç deri në njëmbëdhjetin horizont punon e në të dymbëdhjetin veç pusorja osht' nuk osht' e hapun.

Anita Susuri: Nuk osht' e hapun.

Vjollca Meha: Jo. Mendohet me hulumtime tjera me hapë horizontin tjetër.

Anita Susuri: E a ju kujtohet, a ka qenë, kur keni fillu ju me punu hapja e njëmbëdhjetit horizont? Qato vitet...

Vjollca Meha: Kur kom fillu une me punu kanë ardhë maqinat ma t'mirat prej Suedisë jonë kanë të paketume në oborr të minierës për proçes të prodhimit që janë përdorë që janë porositë për me e lshu minierën edhe me i lshu në prodhim. Në qat' vit që kom fillu une ka fillu metoda me spirale për shfrytëzimin e trupit xehror me spirale, ajo shkon në hapësirë ma t'madhe, mundet me i marrë dy punishte edhe tash horizonti i njëmbëdhjetë ka qenë në fillim të aktivitetit.

Anita Susuri: E juve kështu miniera qysh iu dukte, a iu dok si ni botë n'vete, a çfarë përshtypje keni pasë?

Vjollca Meha: Kur jom kthy prej ditës të parë kur jom shku në minierë, kur jom kthy n'shpi ka qenë gjyshja, nana e nanës teme prezent aty e isha lodhë po s'e pashë atë lodhjen vet. E po thotë, "Qysh e kalove n'punë?" Thashë, "Mirë". "E ku ke?" Thashë, p'i tregoj, thashë, "Jom hi në minierë", "Uuu qyqe, me kry gjithë atë shkollë edhe me hi poshtë n'tokë" (qeshë). E tani thojsha, "Ju po thoni deri në shtatë metra, tash aty mujnë me shku edhe ma thellë edhe aty osht' tjetër botë po osht' ni tjetër".

Përpara ka qenë ni ngrohtësi kur ke shku ti n'minierë, e ke pasë, si me thanë, ni mbështetje pak ma ndryshe. Kemi pasë respektin prej punëtorëve, kemi pasë, kanë qenë në nivel, nuk, bile me kto teknikat serbe u ankojshin thojshin, "Pse po i respektojnë kto ma shumë? Jonë ardhë qitash edhe po i respektojnë". Ata na respektojshin se na ishim femra shqiptare. Ata pak ma ndryshe ish ai shiqimi në krahasim me inxhinierën në teknik.

Anita Susuri: Po vazhdojmë tash ka qenë janar edhe veç fundi, po me 20 shkurt ka fillu greva, qysh erdhi deri te lajmi edhe qysh u prit prej juve fillimisht edhe prej kolegëve?

Vjollca Meha: Kur u ardhë lajmi, tha, "Po mbyllen minatorët". Na ishim afër, se ndërtesa e shërbimit teknik është afër hymjes së minierës. Na si të reja diqysh e ndim atë ftoftësinë, nifare pasigurie se Sigurimi Shtetnor u sillke, na i njoftshim kështu si figura. Ata çdo herë na përcjellshin neve në lëvizje edhe p'i thojna na ni kolegut, na e diskutojshim tani çdo herë e ma tepër u diskutojke tani puna e minatorëve, puna politike. Kur po thotë, tha, po i thojna ni kolegut aty, "A bon me shku na me ju bashkangjitë?" Tha, "A po keni qef me ardhë?" Thashë, "Po na jena qitu. Sa rrijna qitu me shkiqe, me serbë..." Se na n'zyre kishim serbë. Ata na vëzhgojshin, kqyrshin kush po shkon tani me thanë masanej jeni kanë atje s'jeni kanë n'punë, edhe shkum.

Kur shkum me atë kolegun edhe po thotë, ishin kujdestaritë, ia nisën u caktun kujdestaritë. Ishim me shiritat e kuq {bën me dorë te krahu}, i ngjitën shiritat e kuq n'durë edhe ata ishin përgjegjës për situatën tani kush po hyn, kush po del. Edhe po shkojna na me to, kur ai po thotë, "Ti", tha, "Ibrahim", tha, "munësh". Tha, "A këto", tha, "s'bon!" Tha, "Kush jonë këto?" Na metëm se ishim punëtores t'reja. Po ai kolega po i thotë, tha, "Po këto", tha, "janë punëtores që jonë pranë tash e jonë tonat e të reja". Tha, "A kena siguri me i lonë?" Tha, "Po more, qysh jo, qysh, po të siguroj për veti, po të siguroj edhe për këto se të dyjat janë familjeve të mira". Edhe kur ia shtjelloj pak punën, na la.

Tani hynëm na, vizitum, gjendja, na u dokë krejt ni tjetër botë. Diqysh sikur u izolum; as lajme, as... po mendoj lajme të mira jo. Vishin delegacionet njo pas njo, me Kolgecin e ky Stipe Shuvari, e ky Morina e

krejt rend, që vishin delegacionet nuk ishin, ishim në atë atmosferën e zyrtë. T'u mendu që me u ndalë "Trepça" ni ditë osht' ni krizë shumë e madhe, por nuk kish zgjidhje kurrfare atëherë. Në horizontin e tetë u tubun punëtortë, jemi konë nja dy here jemi konë, jemi lshu poshtë, se as në korpa poshtë nuk lshojshin për me shku poshtë te minatortë. Këta në sipërfaqe thojshin, "Jo se po shkoni po rrini atje", ata poshtë thojshin, "Mos i lshoni se po na bojnë presion këtu".

Edhe jemi dalë e sallën e punëtorëve e kanë bo tani si spital, se tani filloi edhe ajri edhe mungesa e dritës, kushtet, grumbullimi i njerëzve ma shumë, ajri ma i zontë edhe fillunë sëmundjet e lodhjet e rraskapitjet, pagjumësia, mos me pasë ushqimin e mirë, edhe e bonën stacionarin ku osht' salla e punëtorve në katin e dytë. Edhe zyret, janë konë edhe zyret e prodhimit ato, edhe zyret e prodhimit u bonën stacionare edhe ia nisën me tri-katër shtretër, tani u zgjanu se ia nisën me ardhë ndihma edhe përkrahje prej krejt Kosovës.

Na kemi vazhdu kemi mbështetë, jo kur jonë dalë punëtortë i kemi ndihmu, jo i kemi ndihmu me pastrim, jo me barna, qishtu. Se aty tani jonë kanë... edhe na i kemi pasë edhe ambulantën në Stantërg ka qenë tani erdhën edhe ata mjektë e ambulantës, punëtortë shëndetësor të ambulantës iu bashkangjitën poshtë. U bo krejt ni ekipë. Ia nisën me u bo numri ma i madh që dilshin prej minierës të lodhun, të rraskapitun edhe shërbimi teknik ku ishim na, u bo stacionar mjekësor, u bonën dy stacionet.

Vishin delegacionet, vishin ndihmat, vishin përkrahjet prej t'gjitha anëve. E prej lodhjes qaq të madhe që kom pasë, se ni kohë e gjatë pagjumësia e tonat, më lshoi trupi s'mujsha m'u ngritë. Edhe po ma bon ni anesteziolog u konë, Nuredin Fazliu, po ma bon, tha, "Çka u bo? Mos edhe ti je smutë?" Thashë, "Jo jo s'jom smutë, po s'po muj m'u çu n'kamë". Se tash t'u nejt trupi krejt, mu tensioni m'ra. "Qitash", tha, "ta jap ni koktell", tha, "ki m'u çu", e ma jepi ni injeksion. Ata e morën ni aksion, hajde po shkojna n'shpi po pastrohem e po kthehem në mëngjes. Po ish veç ni autobus edhe n'qat' autobus na e bonëm me atë shoferin që me ardhë me na marrë edhe prapë në mëngjes. E lam orën e caktume në 6:00 m'u kthy prapë, ai autobus me na mbledhë kah na ka lonë nëpër shpia me na çu apet.

Kur jom ardhë une n'shpi, qaq mo prej lodhjes as s'kom ditë kur jom ra, as me kond kom folë as me kond jom përshëndetë. Baba jem, nana jem t'u m'vetë mu, "Çka u bo? E pse? Qysh osht' situata?" Une hiç s'kom ditë as çka kom dhanë përgjegje. Tek t'nesërmen në mëngjes edhe plus ka pasë mysafirë në shpi. Të nesërmen jena shkue prapë jena shku në minierë, kur jena shku osht' ardhë lajmi që po dalin. Nuk dojshim me dalë se dy herë erdh lajm i rrejshëm që duhet me dalë se osht' nënshkru që mos me u ndrru kushtetuta...

Anita Susuri: Kanë dhanë dorëheqje.

Vjollca Meha: Po, kanë dhanë dorëheqje. U konë ajo lista e kërkesave edhe tani derisa jonë hi edhe krejt stafi i drejtorave, udhëheqsave edhe jonë dalë n'atë mramje. Të nesërmen të gjithë jonë ardhë i kanë marrë edhe policia kush i ka gjetë në stacionar aty i ka marrë policia meniherë. Tani i ka marrë edhe grupin e famshëm 13-tshin e drejtorave në burg. Tani u ftof situata edhe ma tepër. Kurrë s'kena folë, kena folë veç zyrtarisht, kemi kry qit' punë edhe e kemi marrë e kemi kry punën edhe s'kemi folë me ta.

Mandej, kemi majtë kah ni orë, ka qenë edhe greva e dytë, po neve na lshunë n'shpi edhe nuk na kanë lanë me shku. Tani mas ni jave hinën masat e dhunshme, policinë e kena pasë në hymje të kapisë, të portës, policia speciale e ish Jugosllavisë atëherë u konë ka pasë boshnjakë, e serbë, e maqedonë, e tulifare. Edhe në zyre na jemi konë me policë. Ka qenë ni malltretim shumë i madh psiqik.

Anita Susuri: E sa keni qenë në grevë, sa ju ka ra me nejtë mrena në zgafellë?

Vjollca Meha: Jo, në zgafellë nuk kemi nejtë.

Anita Susuri: A keni hi kështu kohë pas kohe?

Vjollca Meha: Kështu kohë pas kohe jemi hi nja dy-tri here kah dy-tri orë edhe jemi dalë, se ma tepër kanë nejtë punëtortë që janë konë të minierës.

Anita Susuri: E kur shkojshit atëherë, qysh e vrejshit atmosferën? Po thoni që ka qenë e randë, po qysh kanë qenë ata? Çfarë gjendje?

Vjollca Meha: Ka qenë shumë emocionuese, për shembull se janë ardhë edhe fëmia e minatorëve te porta i kanë lypë baballartë. Dojshin me hi në minierë me i pa baballartë, po s'u bojke m'i lshu fmitë në minierë. E ka qenë ajo shumë e prekshme. Ka qenë se do prej lodhjes tepërt edhe të rraskapitjes, "O qitu po dojmë me dekë e s'dojmë me dalë. S'dalim të gjallë, kena me mbetë qitu". Kanë qenë ato shumë të randa janë konë ato pamje, se na në dy antë ishim në presion.

Na për shembull ishim në presion, jo në atë presion, po ishim në presion psiqik. Për shembull, prej gjendjes që e pashim na që janë punëtortë tonë, jonë në atë gjendje dhe kur dilshim naltë prej presionit serb. Non stop kanë qenë edhe shkijet, serbtë kanë qenë asajde, çdo here, "Pse po shkoni? Po kujtoni që po boni diçka". Gjithë kanë qenë me thumbime fjaltë e tyne. Tani në grevën e dytë janë hy me dhunë polictë i kanë nxjerrë, aty nuk kom qenë une hiç. E masandej i kom pa disa punëtorë që prej malltremeve të tyne, të policisë kanë ndiku shumë keq te punëtortë.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Po më intereson kur u kry greva, ju thatë që, domethonë keni qenë në shpi tani jeni kthy. Nëse mundeni me na përshkru qit' pjesë të përfundimit të grevës, ku keni qenë ju? A keni qenë në afërsi aty dikun?

Vjollca Meha: Kur kanë fillu me dalë minatortë, na i kemi pasë, secili e ka pasë organizimin secili nga një punëtor me përcjellë deri në stacionar për shkak të dritës. Edhe i kemi përcjellë deri në stacionar edhe disa kanë lypë me shku në shpi, disa janë metë në stacionar. Na n'atë kohë, disa drejtorë, drejtues të minierave na kanë thanë, "Mos rrini, shkoni edhe ju pushoni", edhe na jena shkue në shpi. Kur jom ardhë, po ma bon ni, kur jena shku na kanë thanë, "Shkoni apat në shpi". S'na kanë lanë me hi, se ishin t'u i marrë, se krejt me ndihma me, krejt ato ndihma që i kanë pru qytetartë e Kosovës, krejt i kanë marrë, i kanë konfisku. Kështu që, kur jena shku, ni drejtues aty po m'thotë, tha, "Shkoni", tha,

“pushoni, e shumë ma mirë që s’jeni konë aty”, tha, “se jonë ardhë policia, po vijnë policia p’i marrin”. Edhe na jena dalë edhe nuk jemi, s’jemi taku me polici hiç. Na jena dalë përpara, ata janë ardhë.

Anita Susuri: Qikjo burgosja kur ka ndodhë, qysh e pritën punëtortë edhe ju personalisht?

Vjollca Meha: Shumë keq, se stafin udhëheqës kur ta burgosin osht’ ni thymje shumë e madhe. Edhe na e kishim, e kishim ni drejtor që u konë shumë i suksesshëm, se n’kohën e tij e ka mrri kapacitetin e prodhimit miniera, maksimumin e prodhimit e ka mrri. E kanë fillu tani me lajme kond p’e marrin në pytje, kond kështu, se kanë fillu tani edhe maltretimet. Na kemi majtë edhe kah ni orë tani në hapësirat, mrena rrethojës të “Trepçës”, ni orë si lloj protestë. U mbledhshim të gjithë puntortë qatu, ni orë e mbajshim protestën. Sigurimi e bojke inxhizimin e kush osht’ e kush s’osht’. Edhe shumë keq u konë. Kur jonë liru prej burgut ka qenë shumë gëzim i madh. U konë dy ditë s’e kemi ditë a jena n’punë, a jena në shoqni, a jena në qytet a... U konë, gëzimi u konë i hatashëm. Jo veç te na puntortë, po krejt qyteti u konë i gjallë, i guzhmushëm. Prej fëmive, të mdhejve, krejt u konë ni gëzim shumë i madh. Po prapë ishim na në masa të dhunshme t’u punu edhe na largun.

Anita Susuri: Çfarë date ka qenë?

Vjollca Meha: Ne kemi qenë, në qershor, jo në gusht, në gusht të ‘90-ës. Qitu te ura jonë dalë policia, patrulla e policisë edhe asni autobus nuk e kanë lanë naltë me shku. Jemi hypë në autobus, jemi ardhë deri këtu, këtu na kanë zbritë edhe na kanë thanë, “Shkoni në shpi!” Deri sa hynëm prapë... tri, katër ditë kemi tentu me shku, s’na kanë lanë. Këtu tani na thanë, “Ani, hypni këtu, po atje...” E kur jena shku asnjë s’e kanë lanë ma. Edhe ma une nuk jom shku, se s’kom tentu me shku se s’na lashin. Kur u majt greva e përgjithshme e krejt Kosovës me 3 shtator [1990] që u konë, mas dy jave neve na i kanë çu librezat e punës, “Përrjashtoheni prej punës për shkak që keni marrë pjesë në grevën e 3 shtatorit”. Edhe pse, 3 shtatori ka qenë në vikend ka qenë, po jemi largu nëse kemi marrë pjesë.

Anita Susuri: E kjo greva për çka ka qenë e 3 shtatorit?

Vjollca Meha: Kundër, se sindikata në krye me Hajrullah Goranin, kush osht’ që i bashkangjitet për të drejtat edhe liritë për mos suprimimin e Kushtetutës së Kosovës, atëherë osht’ majtë [grevë]. Nëpër krejt institucionet janë lajmëru krejt sindikatat që janë për m’u majtë greva edhe shumica tani jonë largu për shkak të grevës. Mirëpo, neve edhe ma herët, neve ma herët na kanë largu.

Anita Susuri: Mas përjashtimit nga puna qysh ka vazhdu puna juj? Me çka jeni mirrë?

Vjollca Meha: Po mas largimit nga puna kemi mendu që s’do të zgjatë shumë. Mirëpo, “Trepça” punojke, po ka punu me disa që jonë kthye edhe vazhdojke punën sa për me punu për veti. Deri në ‘93-tën na s’kemi punu. Në ‘93-tën kom punu në arsim shkollën në Tunel të Parë, “Elena Gjika”, kom dhonë gjeografi edhe matematikë. Dy vjet kom punu ‘93-tën-‘94-tën, ‘95-tën m’kanë largu.

Kom shkue tani, ni vjet kom qenë në Zvicërr te vllau i vogël, ni vjet kom nejt edhe jom kthy. Nuk kom dashtë me hi azil, se kom mujtë me hi azil po nuk m’ka pëlqy jeta jashtë vendit. Edhe pse na i kishim tre jashtë, tre vllazërit jashtë e tri motrat ishim këtu. Nuk mujshim me përballu m’i lanë prindtë. E kështu, dikush me kanë këtu, dikush jashtë e kishim apet mbështetjen. Gjendjen ekonomike nuk e kishim keq për shkak se edhe kur kishim mungesa i plotësojshim prej vllaznive.

Anita Susuri: Ndërkohë a e keni formu familjen e ju? A jeni martu?

Vjollca Meha: Jo, as tash nuk jom e martume.

Anita Susuri: Keni vazhdu me profesionin.

Vjollca Meha: Kom vazhdu me profesionin. Mas luftës, 2002, 2001 kom regjistru magistraturën, por kom kalue në mbrojtje të mjedisit. 2007-ën kom diplomue magistraturën se isha pa punë kur u ktheva, kur jom kthye prej... se gjatë luftës jom konë, edhe gjatë luftës jom konë ni vjet, jena dalë refugjatë jena shku në Zvicërr edhe aty ka qenë ni peripeti shumë e madhe.

Anita Susuri: Qysh ka qenë?

Vjollca Meha: Se tanë kohën gati, gati tanë kohën e luftës kemi qenë këtu në Mitrovicë me motrën edhe me dhandrrin e me dy nipat a nanën, e babën edhe motra vogël kanë kalu në kolonën e parë që u konë të Mitrovicës kanë kalu në Shqipni. Ata jonë konë në Shqipni, na jena sillë kolonën e Mitrovicës deri në Gjakovë e jena kthy apert në Mitrovicë. Mandej, prapë me autobusa menxi që kena kalu, në Ulqin jena shku. Tani prej Ulqinit në të zezën me anije kemi kalu në Itali tani prej Italisë jemi shku në Zvicërr. Në Zvicërr jemi bashku krejt familja, me babë, me nanë, me vllazën, me motra krejt. Kemi nejtë ni vjet edhe në të 2000-tën jemi kthy.

Anita Susuri: E gjatë luftës qysh ka qenë krejt situata në qytet sa keni qenë ktu? Edhe çka ju ka detyru me ikë? A ju ka nxjerrë dikush prej shpisë?

Vjollca Meha: Prej pjesës, fundit të rrugës tonë kanë fillu me na qit' prej shpijave edhe na kanë qit' prej shpijave. Baba jem s'ka dashtë me dalë, ka thanë, "Qysh me dalë prej shpisë, ai s'ka ardhë në shpi hala për me m'qitë". Po viteve '98, neve na kanë kontrollu policia edhe për armë e na kanë shënjestru kështu si familje prej Prekazi. Kur jonë ardhë policia, se na dulëm, se motra e madhe ma e ka pasë shpinë qitu te... të partë i kanë qitë prej shpijave mas shkollës "Eqrem Qabej", te Ura Ibrit. Ia kanë kallë shpinë edhe i kanë largu prej shpijes, ajo s'ka pasë u ardhë te na. Mandej, bashkë jemi dalë, prej atushit jemi shku në Tavnik te mixha.

Kur janë shku, babës i kanë, e kanë vetë babën, si jonë hi i kanë thonë, "Çka po pret ktu?" Ka thanë, "S'muj me dalë prej shpisë", i kanë thanë, "Ja ta rujna na shpinë". Kur njo prej, jonë konë me maska, i ka thonë, "Ku i ki çikat?" Baba e kish atë synim pse po ikni ma herët se na veç ishim shënjestër. Po ajo veç në fund të rrugës ishin hi i qitshin prej shpijes. Ni kojshi i joni edhe baba jem, veç ata dy. Ai tjetrën anë ky tjetrën anë, veç ata dy janë metë në shpija edhe te dytë i kanë qitë edhe iu kanë thonë, "Asni minut mos me ju pa ktu".

Tani na e pritshum në fund të rrugës, në fillim të rrugës e pritshum kqyrshim çka po bohet. Tha, kur erdh tani menzi mrrijti baba, se babën e kom pasë smutë prej Parkinsonit s'ka mujtë me ecë shpejtë. Tha, "Mirë e kishit pasë, se juve ju lypën". Tha, "Si hypën", tha, "ju lypën, gati me ju marrë une n'qaf". Edhe ma tani jemi konë nëpër shpija, prej mixhës e nëpër Tavnik, tani te miqtë e mixhës.

E dikur ma u ngushtum se ish, për shembull, ish shumë rond kur e din gjuhën, kur e din gjuhën e i kupton çka të thojnë. A shumë ma lehtë bon vakia mos me pasë ditë gjuhën e tyne e s'e kishe ditë çka po thojnë edhe pak ma qetë. Na i kuptojshim krejt, e tanë kohën u sillshin me traktora, "Kena me ju pre, kena me ju gri. Pse po rrini ktu? Shkoni te Klintoni, shkoni në Shqipni, s'osht' vendi ju!" A din, çdo herë... se kanga e muzika ma ka qenë maksimum, e tyne.

Na, sa ka pasë popullatë u konë gjithë në heshtje, në heshtje se ti ishe e pambrojtun. Hike nëpër shpija edhe mujke me t'masakru e të gjitha torturat me t'i bo. Kështu që, vendosëm se i kishim edhe dy fëmijë e motrës të ri, për m'i pshtu edhe ata jemi dalë në stacion të autobusave. E kemi pagu goxha ni shumë të markave për person për me shku në Ulqin. Edhe në stacion të autobusave na kanë jep, tash ato ishin, se na jemi dalë, na u harxhitën ushqimet e jemi dalë përtej Urës të Ibrit për me ble ushqim me motrën.

Jemi konë ni grup, po autobusi, po a tash qëllimisht e ka bo ata apo për fitimin e vet, hypshim në stacion të autobusave edhe shkojshim me autobus n'atë pjesën përtej Urës të Ibrit, edhe kur jemi dalë përtej Urës të Ibrit, fati, u dalë lajmi që po bombardojnë edhe jonë ikë nëpër strehimore edhe neve na kanë lonë, "Shkoni!" Se ushqimet na i murrën, kush kish ma tepër, ni qumsht kishe të drejtë me marrë, ni kos, ni, krejt kah njo, jo... na mujshim me ble edhe ma tepër, po s'të jepke, "Jo, se po ia çon UÇK-së".

Bukë patëm marrë se ia nisi mielli me u harxhu, tharmi për m'i qit' bukë. Une sot buknore s'kom qef me pa, se gjatë kolonës kemi honger buknore. I thojshim buknore, po ajo jo nore, veç ujë e mill. Edhe motra ku u konë, motra ku jemi nalë, u hi e ka gat u kah ni bukë edhe e kemi pasë kah ni bukë me veti çdoherë. Ma tepër për fëmi, se na ma t'mdhajt u munojshim me shty me zor.

Në kolonë kemi hjekë shumë, se gjatë kolonës në Shipol kemi pa edhe kufoma që i kanë vra. I kanë lonë qëllimisht edhe i kanë sillë kolonën rreth e rreth. A din, "Tash, ktheni n'shpi se kërkush s'po ju ndjekë". Edhe e kanë qitë kolonën krejt m'u sillë të Shipolit me pa kufomat edhe na kanë qitë apet në kolonë.

Anita Susuri: Thatë që n'vitin 2000 jeni kthy në Kosovë, qysh ka qenë kthimi? Jeni kthy në shpi, në çfarë gjendje ka qenë shpija?

Vjollca Meha: Vitin 2000, baba edhe nana s'kanë dashtë me nejt, se na krejt familja ishim atje. Po masi ata dojshin m'u kthy, atëherë vendosëm kush. Une edhe motra edhe dy prindtë jemi kthy. Kur jemi kthy, shpija ka qenë e djegme, çdo gja e shkatërrume. Unë e kom pa edhe kur kemi dalë përtej Urës të Ibrit që ka qenë krejt qendra ka qenë rrafsh, s'ka pasë as shpija, as kurgjo hiç. Mandej, i kanë ndërtu këto bizneset e vogla. Gjithçka u konë e shkatërrume.

Bile krejt rrugës, ku kom banu une shpija jeme ka qenë e djegme edhe shpijat tjera të mahallës tjetër. S'kemi pasë kurrfarë ndihme, vet e kemi renovu me ndihmën, normal, vllaznit kanë investu edhe i kemi adoptue tani. Ka qenë ni gëzim i madh, se jena kthy në shpi tonë. Ka qenë ajo euforia që jemi të lirë me dalë ku t'dush shirë, pa t'nalë dikush me t'thonë n'tjetër gjuhë, "Ka po shkon? A kah po don a?" Gjithçkafin, kond e ke pa ka qenë i gëzushëm. Momentet e para çdo here ke kqyrë me pa ni të afërm tanin, me takue.

Çdo here me hulumtue e janë tanë gjallë, a e ka vra dikanin të familjes a qysh krejt. Mu gjyshja m'ka dekë, nana e nanës m'ka dekë n'luftë edhe halla e nanës, grunë e axhës e kanë vra në shpi në katun, i kanë zanë serbtë edhe e kanë vra. Derisa e ka çelë ajo derën, ai ka menu që po e mshef dikanin edhe si e ka çelë derën e ka mytë. Në shpi e ka mytë.

Tani ato, u kompletu familja, ia nisën për me shku n'punë. Tani ish problemi i punës, na s'kishim punë. Disa organizata që ishin veç ishin rahatu se ata ishin shumica ishin ardhë prej Shqipnisë edhe me këto kontigjentet e Shqipnisë kishin vazhdu këtu. Mrena ditës 20 vena kena qitë kërkesë edhe unë edhe motra me hi në punë. Baba t'u i ngu lajmet po thotë, "More diçka po thotë për 'Trepçën'". Jom hypë, kur jom dalë te stacioni s'ka pasë autobus.

Tash t'u pritë me ardhë ni autobus ose ni kombi, se s'ka pasë as qarkullim për Stantërg, edhe po e takoj ni kolegë të fakultetit, "Ku po don me shku?" Ai punojke në KEK. Thashë, "Vallai", thashë, "dashta me shku në 'Trepçe' me kqyrë për punë", tha, "Hajde", tha, "se edhe na jena ka shkojmë qanena", edhe jom shkue. Kur jom shkue, ish kanë tubimi i punëtorëve edhe po ma bojnë dy kolegë, po thojnë, "Vjollcë", thotë, "hajde", ish e premte, "Hajde të hanën, vjen ai drejtori", se ka qenë ekipi i të hujve ITT-ja, se me UNMIK qysh janë ardhë kompanitë. "Hajde", tha, "edhe folë me atë drejtorin e nashta të kthen në punë". E jom shku të hanën.

Kur jom shku të hanën u konë ni sfidë se puntortë tonë s'kanë pasë të drejtë me të lshu mrena në objekt të "Trepçës". Po pak ish edhe koha e gjatë që s'ishim pa tash edhe ndryshimi, ka ndrru edhe pamja [jashtme] edhe e jona, se tani ishim pak ma t'pjekun se dhetë vjet ma të vjetër. Edhe po thotë, tha, "Vallai, nuk guxoj me të lshu veç që e njeh dikanin prej minierës, prej inxhinierave, drejtorave", tha, "Ata vijnë e t'marrin", edhe une po ia numëroj a osht' ky, a osht' ky, a osht' ky. Tha, "Valla, tanë janë, veç ty s'po të ngjohum". Ish kanë ni amerikan aty edhe po ma bon, po afrohet niherë, "Ha", tha, "çka po don?" Thashë, "Qishtu, qishtu, kom punu e erdha", "Eh", tha, "mirë, hajde me mu". E shkum te drejtori i ekipit të hujë.

Bisedum me të, tha, "Po tash te presim deri t'na vjen inxhinieri, gjeologu te kqyrim a ka nevojë a s'ka nevojë". Tani i kom pritë kolegtë, kom bisedu me ta. Ata shkunë në minierë, thashë, "Ishalla nuk vonoheni shumë se unë me nejtë ktu", tha, "Po edhe me dalë", tha, "s'ki qysh me shku", tha, "se s'ki transport", "Kur te kryjna", tha, "dalim bashkë".

Kur jena dalë, kur jonë dalë ata prej minierës me atë gjeologun e hujë u ardhë edhe ma ka jep kontratën, "Nënshkruje kontratën", të nesërmen kom fillu punën. Edhe jom konë femna e parë që jom kthy mas luftës. Ato, po mendoj, në restaurant jonë konë edhe dy a tri, po prej stafit të inxhinierave prej femnave jom konë une. Tani gradualisht me zhvillimin e punëve edhe jonë kthy puntortë grupe-grupe, se jo përnihërë s'i kanë lonë.

Anita Susuri: A ju keni kthy meniherë punës të zakonshme me studimin e tokës apo?

Vjollca Meha: Gjashtë muj, po tani mas gjashtë mujve kom fillu në Muze të Kristaleve. Jom konë edhe e kom udhëheqë muzeun e kristaleve deri në 2012, 2013. Kur osht' ndërtu objekti i ri, tani osht' bo bartja e kristaleve edhe ka kalu muzeu tani me Ministrinë e Zhvillimit. Tani unë jom tërhjekë, jom kthy në "Trepçe".

Anita Susuri: E qysh ka funksionu Muzeu? Ka pasë artefakte, veç kristale apo?

Vjollca Meha: Jo, Muzeu u kanë veç i kristaleve. Të gjitha llojet e kristaleve që janë konë në “Trepçe” edhe ka pasë edhe të jashtit ma shumë që kanë bo shkëmbimin me shtete tjera. Muzeu atëherë u konë, muze. S’ke mujtë ti me vizitu kur don, se vizitat kanë qenë të nivelit të naltë. Delegacionet e Jugosllavisë që janë ardhë, janë ardhë aty se edhe janë ardhë në vizitë edhe biznesin që kanë pasë po ka qenë edhe hoteli i “Trepçës”, kanë banu edhe në hotel.

Anita Susuri: E Muzeu, kristalet që janë sjellë aty, a i ka identifikuar dikush?

Vjollca Meha: Po, po. Krejt kanë qenë të regjistruar, të fotografuar, mbikqyrje tani selektimi e krejt janë konë.

Anita Susuri: Nëse doni edhe diçka me shtu?

Vjollca Meha: Prej 2012-ës tani kom kaluar jom ardhë këtu në Departamentin e Mbrojtjes së Mjedisit në kuadër të “Trepçës”.

Anita Susuri: Tash vazhdoni?

Vjollca Meha: E tash vazhdoj derisa të kemi shëndetin (qeshë), e vazhdojmë në qit’ departament.

Anita Susuri: Mirë shumë.

Vjollca Meha: Për arsye se e kom bo ndërrim përpara nuk ke pasë ti mundësi për shembull sikur tash që osht’ sistemi i shkollimit po m’duket osht’ ma ndryshe. Nuk osht’ që më pëlqen ky sistem tash, për arsye se përpara ti ke qenë inxhinier i gjeologjisë, ke magjistru në gjeologji, ke doktoru në gjeologji, kurse tash po kryen gjeologji, po kalon në ekonomi, po kalon krejt në tjetër edhe faktikisht për mu ajo s’osht’ kurgjo. Tash po me këto metodat e reja po osht’ diçka në përzirje, ai s’mundet me konë fort i fortë në atë kuptimin me në lami.

Une kom, gjeologjinë e kom kry për vjeçarë, po kom kalu në mbrojtje të mjedisit, po mbrojtja e mjedisit ka shumë ngjashmëri me gjeologjinë. Se sikur në gjeologji që e msojmë që duhet, ti e mëson qat’ resurs natyror, po duhet me kultivuar prapë, duhet me kthyer në gjendjen qysh ka qenë ma parë. Edhe mjedisi, ti e shfrytëzon po prapë duhet me pasë në konsideratë ndaj natyrës apo duhet... po na si “Trepçe” kemi probleme të mdhaja, për arsye se osht’ gati 60 vjet bohet që janë formu deponitë. Sa kohë osht’ ardhë deri në atë akumulimin e materialit, mbetjet e materialit qat kohë vënë për m’u hjekë.

Anita Susuri: Po. Zonja Vjollcë, nëse s’keni edhe diçka me shtu për fund ju kisha falënderu shumë për intervistën.

Vjollca Meha: Faleminderit edhe prej juve që keni gjetë kohë, diçka s’kisha pasë me shtu.

Korab Krasniqi: Faleminderit shumë.